

## **Performanca dhe impakti i veprimtarisë audituese të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për vitin 2016**

Në datën 27 Janar 2017, Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, zhvilloi në ambientet e Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës, analizën vjetore të vitit 2016, me temë “Performanca dhe impakti i veprimtarisë audituese të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, përgjatë vitit 2016”.

Pjesëmarrës në këtë analizë, përveç audituesve të departamentit, ishin dhe znj. Luljeta Nano Sekretare e Përgjithshme e KLSH, Prof. Dr. Ago Nezha dhe Prof. Dr. Sherif Lushaj, ekspertë të jashtëm në KLSH, anëtarë të stafit akademik dhe studentë të Fakultetit të Biznesit, si dhe të ftuar znj. Aulona Jonuzi Kryeaudituese dhe z. Sali Agaj, auditues të KLSH.

Analiza vjetore filloi me fjalën përshëndetëse të Sekretares së Përgjithshme znj. Luljeta Nano dhe me fjalën përshëndetëse të Zv.Dekanit të Fakultetit të Biznesit, Dr. Llambi Prendi. Analizën e departamentit e përshëndetën edhe Prof.Dr. Ago Nezha dhe Prof.Dr. Sherif Lushaj.



Analiza Vjetore 2016

Më pas fjalën e mori Drejtori i Departamentit z. Alush Zaçe, i cili vijoi me prezantimin përmbledhës për punën audituese gjatë vitit 2016, arritjet, mangësitë dhe sfidat kryesore të departamentit.

Për vitin 2016, Departamenti, sipas Programit të miratuar të auditimeve, ka ushtruar dhe evaduar 18 auditime, nga të cilat 17 auditime përputhshmërie dhe rregullshmërie financiare dhe 1 auditim tematik.

Nga analiza e gjetjeve, Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, për vitin 2016 ka rekomanduar 889 masa gjithsej, nga të cilat 628 masa organizative, 173 masa disiplinore, 78 masa zhdëmtuese, me vlerë 384,371 mijë lekë, janë kryer 7 kallëzime penale për 48 persona, si dhe janë dhënë 10 masa me vlerën 1,031,281 mijë lekë për mungesën e të ardhurave në Buxhetin e Shtetit.

Aktiviteti vijoi me diskutimin mbi nevojën e auditimit të Zonave të Mbrojtura Detare dhe të Pastërtisë së Ajrit nga kryeaudituesi i Departamentit të Performancës, Dr. Aulent Guri, prezantimet e punës audituese të kryera në disa subjekte si: prezantimi i auditimit të kryer në ZVRPP Gjirokastrë nga kryeaudituesi z. Selfo Zeneli; prezantimi i auditimit të kryer në ATP Tiranë nga audituesi z. Artan Mirashi, si dhe prezantimi i auditimit të performancës “Menaxhimi i mbetjeve urbane në Bashkinë e Tiranës” nga audituesi z. Sali Agaj. Prezantimi i këtyre auditimeve u shoqërua me diskutime të audituesve të departamentit.

Risi në zhvillimin e analizës vjetore të departamentit për vitin 2016, ishin dhe disa prezantime të botimeve të KLSH-së, si prezantimi i botimit “Standardet ndërkombëtare të auditimit” nga audituesi Luan Kuka dhe “Konferenca IV-t Shkencore- Analiza e Riskut” nga audituesja Valdete Berisha.

Më pas u vijua me prezantimin e rezultateve të Kontrollit të Cilësisë për auditimet e ushtruara gjatë vitit 2016, nga Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, prezantim i cili u krye nga kryeaudituesja znj. Aulona Jonuzi, anëtare e grupit të Kontrollit të Cilësisë.

Në përfundim, drejtori i departamentit z. Alush Zaçe, prezantoi objektivat e departamentit për vitin 2017, ku puna menaxheriale do të jetë në përputhje të plotë me objektivat e Planit të Zhvillimit Strategjik 2013-2017 të KLSH, të rishikuar për periudhën 2015-2017, për realizimin e objektivave të departamentit dhe të institucionit.